



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 08.06.2021

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.06.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Ekonomik N.SH.T.Viktori Com. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –V-së , me Nr. të Prok: 632-21-585-5-1-1.** nxjerr:

V E N D I M

- II. 1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “N.SH.T.Viktori Com, e dt. 03.06.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –V-së , me Nr. të Prok: 632-21-585-5-1-1 dhe Nr. Brendshëm 632-21-005-511., kundër Njoftimit për kontratë, te AK –së, të datës 11.05.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .
2. Vërtetohet NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 11.05.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

- I. Operatori Ekonomik "N.S.H.T.Viktori Com me datë 03.06.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës pjesa –V-së , me Nr. të Prok: 632-21-585-5-1-1 dhe Nr. Brendshëm 632-21-005-511

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 08.06.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti kontraktues sqaron se kriteret janë përpiluar në bazë të projektit detal për këtë segment të rrugës ku në paramas janë paraparë furnizim dhe instalim të pajisjeve semaforike dhe sinjalizim horizontal dhe vertikal.

Të gjitha EN standardet e kërkuara janë standarde Evropiane të lëshuara nga Organizata Evropiane për Standarde EOS për komponentët e sistemit të semaforëve, ku ekzekutimi i tyre në terren duhet të jetë në përputhje të plotë me specifikat e paramases.

Tipi i folies EG – nuk është brend apo prodhues siç pretendoni por është Engineering Grade (EG) pra është tip i folies dhe si i tillë përdoret në rrugët lokale dhe rrugët nacionale.

Andaj ky fakt mjafton që kërkesa e juaj të konsiderohet e pa bazë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunë